



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2026

PROCESVERBAL

Tipi i kontratës: Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE TË KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS SË PROKURIMIT: Blerje lëndë djegëse, karburant (Naftë,benzinë).

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi kryesor CPV: **09100000-0 – Lëndë djegëse.**

Sipas loteve:

- Loti I dhe Loti II: 09134200-9 – Lëndë djegëse gazoil;
- Loti III: 09132100-4 – Benzinë pa plumb.

FONDI LIMIT:

Fondi limit i procedurës së prokurimit është **12 403 186,858 (dymbëdhjetë milionë e katërqind e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë presje tetëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH**, i ndarë në tri lote, si më poshtë:

1. **Loti I – “Blerje gazoil për automjete”**, me fond limit 2 127 154,788 (dy milionë e njëqind e njëzet e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër presje shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;
2. **Loti II – “Blerje gazoil për kaldaja”**, me fond limit 10 153 697,07 (dhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë presje zero shtatë) lekë pa TVSH;
3. **Loti III – “Blerje benzinë pa plumb për automjete”**, me fond limit 122 335 (njëqind e njëzet e dy mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Në mbështetje të nenit 21, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 2, pika 2, shkronja “c”, dhe nenit 78, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve

Publike, ka hartuar këtë procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe të kriterëve për kualifikim për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve për kualifikim, Autoriteti Kontraktor ka mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 42, pika 3, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, sipas së cilës: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahen në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Gjithashtu, është mbajtur në konsideratë pika 9 e nenit 42 të së njëjtës VKM, sipas së cilës: “Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.”

Në përputhje me këto dispozita, specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit janë hartuar, argumentuar dhe miratuar veçmas për secilin lot, duke marrë në konsideratë objektin, natyrën, sasinë, mënyrën e realizimit dhe fondin limit përkatës.

Operatorët ekonomikë lejohen të paraqesin ofertë për një, disa ose të gjitha lotet dhe mund të shpallen fitues për një, disa ose të gjitha lotet, me kusht që të përmbushin kërkesat dhe kriteret e përcaktuara për secilin lot. Për secilin lot paraqitet ofertë e veçantë dhe vlerësimi kryhet në mënyrë të pavarur.

Kur operatori ekonomik paraqet ofertë për më shumë se një Lot, ai duhet të plotësojë kriteret e kualifikimit të përcaktuara për secilin Lot për të cilin ofertuesi konkurron. Kur kriteret janë të shprehura në vlera financiare, operatori duhet të plotësojë vlerën kumulative të kërkuar për Lotet për të cilat ofertuesi konkurron.

LOTI I – “Blerje gazoil për automjete”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të neneve 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 26 dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Neni 76 i ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, përcakton kriteret detyruese për skualifikimin e operatorëve ekonomikë.

Në mbështetje të nenit 82 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, së bashku me ofertën, Autoriteti Kontraktor pranon Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të kërkesave të tjera të deklarueshme. Përmbajtja dhe mënyra e përdorimit të këtij formulari përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në zbatim të kësaj dispozite dhe të nenit 26 të VKM-së nr. 285/2021, e ndryshuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9 të DST-së. Dokumentacioni provues paraqitet sipas fazës dhe procedurës së përcaktuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe në DST.

Sipas nenit 83, pika 1, të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në mbështetje të nenit 83, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 162/2020 dhe të nenit 30, pika 1, të VKM-së nr. 285/2021, e ndryshuar, vlera e sigurimit të ofertës përcaktohet në masën 2% të vlerës së përlogaritur të kontratës. Sigurimi i ofertës paraqitet sipas Shtojcës 4 të DST-së dhe duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

Sigurimi i ofertës synon të garantojë seriozitetin dhe qëndrueshmërinë e ofertës gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj, si dhe përmbushjen e detyrimeve të ofertuesit që lidhen me procedurën e prokurimit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të përmbushë kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, sipas përcaktimeve të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Shtojca 9 e DST-së.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të neneve 76, 77, pika 2, dhe 82 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Neni 77, pika 2, i ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, parashikon se, për të provuar përshtatshmërinë për ushtrimin e veprimtarisë profesionale, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të jenë të regjistruar në regjistrat profesionale ose tregtarë përkatës, sipas legjislacionit në fuqi.

Në mbështetje të nenit 26 të VKM-së nr. 285/2021, e ndryshuar, operatori ekonomik, nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, deklaron se është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron veprimtarinë, ka status aktiv dhe ka në objektin e veprimtarisë aktivitetin që lidhet me objektin e prokurimit.

Përmbushja e kriterëve të përgjithshme dhe e kërkesave për përshtatshmërinë profesionale deklarohet paraprakisht në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST-së, ndërsa verifikimi i dokumentacionit provues kryhet sipas fazës dhe mënyrës së përcaktuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe në DST.

Kriteri synon të verifikojë se operatori ekonomik ushtron ligjërisht veprimtarinë, ka status aktiv dhe disponon përshtatshmërinë profesionale bazë për realizimin e kontratës. Duke qenë se nuk vendos kërkesa shtesë përtej atyre të parashikuara nga legjislacioni dhe dokumentet standarde të tenderit, kriteri zbatohet në mënyrë të barabartë dhe nuk kufizon konkurrencën.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Për të provuar kapacitetin ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025.

Vlera e xhiros, në të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të Lotit I, përkatësisht 850 861,92 (tetëqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një presje nëntëdhjetë e dy) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të kërkuar të xhiros në të paktën një nga tri vitet financiare të përcaktuara.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 43, pikat 1, 2, shkronja “c”, 3 dhe 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Neni 77, pika 3, i ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, parashikon se autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për zbatimin e kontratës, përfshirë kërkesa

për një xhiro vjetore minimale të caktuar. Kur kontrata ndahet në lote, kjo kërkesë zbatohet për secilin lot individual.

Sipas nenit 43, pika 1, të VKM-së nr. 285/2021, e ndryshuar, për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë deri në tri vitet e fundit financiare.

Në mbështetje të nenit 43, pika 2, shkronja “c”, të së njëjtës VKM, vlera e xhiros minimale vjetore që kërkohet në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit.

Sipas VKM-së nr. 291, datë 15.05.2024, “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik, koncesionet dhe partneritetin publik privat”, e ndryshuar me VKM-në nr. 331, datë 13.05.2026, kufiri i ulët monetar për kontratat e mallrave në sektorin klasik është 10,000,000 lekë. Fondi limit i Lotit I është 2,127,154.788 lekë pa TVSH dhe, për rrjedhojë, ky lot është nën kufirin e ulët monetar.

Në përputhje me nenin 43, pika 3, të VKM-së nr. 285/2021, e ndryshuar, kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të kërkuar të xhiros në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Përcaktimi i xhiros në masën 40% është vlerësuar i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për të provuar se operatori ekonomik disponon kapacitetin financiar për të garantuar furnizimin e vazhdueshëm me gazoil gjatë zbatimit të kontratës. Realizimi i kontratës kërkon që operatori të sigurojë disponueshmërinë e produktit, funksionimin e pandërprerë të sistemit të furnizimit dhe përmbushjen në kohë të kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Kërkesa nuk tejkalon kufirin e lejuar nga legjislacioni i prokurimit publik, është në përputhje me natyrën dhe vlerën e Lotit I dhe nuk krijon pengesa të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Periudha 2023–2025 përfshin tri vitet e fundit financiare të mbyllura përpara zhvillimit të procedurës në vitin 2026. Dokumentacioni për xhiron paraqitet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar në DST dhe në legjislacionin në fuqi.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë përmbushur detyrimet e maturuara për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025, si dhe këstet e maturuara të vitit 2026, në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe afateve të pagesës të përcaktuara nga secila njësi.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, si dhe në çdo rast kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 76, pika 2, dhe nenit 82 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 26, pikat 2, shkronja “dh”, dhe 6, të

VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Kërkesa synon të verifikojë përmbushjen e detyrimeve fiskale vendore, në përputhje me ligjin nr. 9632/2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Dokumentacioni provues paraqitet nga ofertuesi i renditur i pari, sipas fazës dhe mënyrës së përcaktuar në DST dhe në legjislacionin e prokurimit publik. Kriteri përfshin vetëm detyrimet e maturuara dhe respekton rastet përjashtimore të nenit 76, pika 2, të ligjit.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa furnizimeve të mëparshme, të ngjashme me objektin e Lotit I, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Vlera e përgjithshme e furnizimeve të ngjashme duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të Lotit I, përkatësisht 850 861,92 (tetëqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një presje nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Për qëllime të këtij kriteri, konsiderohen të ngjashme furnizimet me gazoil dhe/ose karburante të tjera të lëngshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore³⁷, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Këto dispozita i lejojnë Autoritetit Kontraktor të kërkojë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Vlera e përgjithshme e kërkuar nuk mund të jetë më e madhe se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit.

Kriteri synon të verifikojë se operatori ekonomik ka përvojën e nevojshme për realizimin e furnizimit me karburant. Pranimi i një ose disa furnizimeve dhe përfshirja e karburanteve të tjera të lëngshme shmang kufizimin e përvojës vetëm të kontrata identike dhe garanton konkurrencë e trajtim të barabartë.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë ose të ketë në dispozicion të paktën 1 (një) stacion të licencuar për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjete, brenda qytetit të Shkodrës, nëpërmjet të cilit do të realizohet furnizimi i automjeteve të Autoritetit Kontraktor.

Duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtme:

- a. Licenca/autorizimi i vlefshëm për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjete, i lëshuar nga Bashkia Shkodër;
- b. Leja mjedisore e tipit B, e vlefshme, e lëshuar sipas legjislacionit mjedisor në fuqi;
- c. Vërtetimin Teknik të vlefshëm për respektimin e normave dhe kushteve teknike të stacionit të tregtimit me pakicë të karburanteve, të lëshuar nga një Organ i Miratuar për Vlerësimin e Konformitetit (OMVK), sipas Urdhrit nr. 315, datë 24.08.2017.
- ç. Certifikata e vlefshme e mbrojtjes nga zjarri, Akti Teknik ose dokumenti tjetër i vlefshëm, i lëshuar nga shërbimi kompetent i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH), që provon përmbushjen e kërkesave për mbrojtjen nga zjarri;
- d. Dokumenti që provon disponimin e stacionit nga operatori ekonomik.

Disponimi i stacionit mund të provohet me dokument pronësie, ekstrakt të QKB-së, kontratë qiraje, kontratë furnizimi, marrëveshje bashkëpunimi ose dokument tjetër të vlefshëm juridik

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pikat 1, 2 dhe 4, dhe nenit 84 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 3, pika 5, shkronjat “a” dhe “ç”, pika 8, dhe nenit 90 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Kriteri mbështetet gjithashtu në:

- nenin 20 të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;
- kreun II, pika 1, shkronja “b”, të VKM-së nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, e ndryshuar;
- ligjin nr. 10 448, datë 14.07.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar;
- ligjin nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”, i ndryshuar;
- urdhrin nr. 315, datë 24.08.2017, “Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar.

Licenca/autorizimi provon se stacioni ushtron ligjërisht veprimtarinë e tregtimit me pakicë të karburanteve. Leja mjedisore provon respektimin e kërkesave për parandalimin dhe kontrollin e ndikimeve në mjedis, ndërsa vërtetimi teknik provon plotësimin e kërkesave teknike dhe të sigurisë nga stacioni dhe pajisjet e tij.

Karburantet janë produkte të ndezshme dhe aktiviteti i depozitimit dhe tregtimit të tyre paraqet rrezik të shtuar për zjarr dhe shpërthim. Për këtë arsye, dokumenti i lëshuar nga MZSH-ja është i nevojshëm për të provuar përmbushjen e kërkesave ligjore për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

Autoriteti Kontraktor përdor çdo ditë automjetet për realizimin e detyrave funksionale në qytetin e Shkodrës dhe në territorin ku ushtron veprimtarinë. Disponimi i të paktën një stacioni brenda qytetit të Shkodrës është i nevojshëm për garantimin e furnizimit të vazhdueshëm dhe në kohë, shmangien e kilometrave, kostove dhe kohës së panevojshme dhe ruajtjen e gatishmërisë së automjeteve.

Për të mos kufizuar konkurrencën, stacioni nuk kërkohet të jetë domosdoshmërisht në pronësi ose në administrim të drejtpërdrejtë të ofertuesit. Pranohet çdo formë e ligjshme disponimi, me kusht që të provohet se stacioni dhe kapacitetet e tij do të jenë realisht në dispozicion gjatë gjithë periudhës së furnizimit.

Kriteri lidhet drejtpërdrejt me ligjshmërinë, vazhdimësinë, përshtatshmërinë teknike, mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë nga zjarri të pikës së furnizimit. Për këto arsye, ai është i lidhur dhe proporcional me objektin dhe mënyrën e realizimit të Lotit I dhe nuk kufizon në mënyrë të pajustificuar konkurrencën.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), nëpërmjet të cilit të vërtetohet se subjekti që do të realizojë furnizimin ka tregtuar karburante në përputhje me standardet dhe legjislacionin shqiptar në fuqi dhe se, sipas evidencave të ISHTI-t, në datën e lëshimit të vërtetimit nuk rezulton të ketë masa administrative përfundimtare në fuqi për shkelje të cilësisë së karburanteve.

Vërtetimi duhet të jetë lëshuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve përpara datës së hapjes së ofertave.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 8, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Kriteri mbështetet gjithashtu në:

- ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;
- VKM-në nr. 147, datë 21.03.2007, “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”, e ndryshuar;
- ligjin nr. 10 433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM-në nr. 410, datë 13.05.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, e ndryshuar;
- urdhrin nr. 6, datë 09.01.2015, “Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse”, i ndryshuar.

Neni 77, pika 4, i ligjit nr. 162/2020 lejon përcaktimin e kërkesave për aftësinë teknike dhe profesionale, përfshirë besueshmërinë e operatorit ekonomik për realizimin e kontratës. Neni 40, pika 8, i VKM-së nr. 285/2021 lejon vendosjen e kriterëve të tjera të veçanta që vlerësohen të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me kusht që të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e prokurimit.

Objekti i Lotit I është furnizimi me gazoil i automjeteve të Autoritetit Kontraktor. Cilësia e karburantit ndikon drejtpërdrejt në funksionimin, sigurinë dhe mirëmbajtjen e automjeteve. Furnizimi me produkt jashtë standardeve mund të shkaktojë dëmtime të motorëve, ndërprerje të punës dhe kosto shtesë mirëmbajtjeje.

ISHTI është institucioni shtetëror që ushtron funksione inspektimi dhe kontrolli në fushën e tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj. Vërtetimi i lëshuar prej tij mundëson verifikimin e të dhënave zyrtare të administruara për subjektin që do të realizojë faktikisht furnizimin.

Afati prej 30 ditësh është vendosur për të garantuar që informacioni të jetë i përditësuar në datën e hapjes së ofertave. Kriteri nuk lidhet me çdo masë të vendosur më parë, por vetëm me masat administrative përfundimtare që rezultojnë në fuqi në datën e lëshimit të vërtetimit. Masat e shfuqizuara, të pezulluara ose që nuk kanë marrë formë përfundimtare nuk merren në konsideratë.

Kërkesa zbatohet njëllë për të gjithë ofertuesit dhe lidhet drejtpërdrejt me besueshmërinë e subjektit që do të realizojë furnizimin me karburant. Për këto arsye, kriteri është vlerësuar i lidhur dhe proporcional me objektin e Lotit I.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analize ose raport prove për gazoilin e ofruar, të lëshuar nga:

a) Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI); ose

b) një laborator testues i akredituar sipas standardit SSH EN ISO/IEC 17025:2017 ose ekuivalent, nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga një organ kombëtar akreditimi i një shteti tjetër, nënshkrues i marrëveshjes EA MLA ose ILAC MRA në fushën e testimit.

Fleta e analizës ose raporti i provës duhet:

- të jetë lëshuar gjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve të fundit përpara datës së hapjes së ofertave;
- të identifikojë produktin e analizuar;
- të përmbajë treguesit, metodat e provës dhe rezultatet e analizave të kryera;
- të provojë përputhshmërinë e gazoilit me standardin SSH EN 590:2025 ose ekuivalent;
- kur lëshohet nga laborator i akredituar, testet dhe parametrat e pasqyruar në raport të përfshihen në fushën e vlefshme të akreditimit të laboratorit.

Kur raporti nuk është lëshuar në emër të ofertuesit, duhet të paraqitet dokumentacioni që provon lidhjen e ofertuesit me produktin e analizuar dhe burimin përkatës të furnizimit.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 79 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 6, shkronja “c”, dhe nenit 44 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Kriteri mbështetet gjithashtu në:

- ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;
- VKM-në nr. 147, datë 21.03.2007, “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”, e ndryshuar;
- standardin SSH EN 590:2025 ose ekuivalent;
- standardin SSH EN ISO/IEC 17025:2017 ose ekuivalent.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të verifikojë se gazoili i ofruar përmbush karakteristikat teknike dhe treguesit e cilësisë të përcaktuar në specifikimet teknike dhe në standardin SSH EN 590:2025 ose ekuivalent. Cilësia e gazoilit ndikon drejtpërdrejt në funksionimin, sigurinë dhe mirëmbajtjen e automjeteve të Autoritetit Kontraktor.

Akreditimi sipas standardit SSH EN ISO/IEC 17025:2017 ose ekuivalent provon kompetencën teknike dhe paanshmërinë e laboratorit për kryerjen e analizave. Kërkesa që testet dhe parametrat e raportuar të përfshihen në fushën e vlefshme të akreditimit garanton se laboratori është kompetent për kryerjen e analizave konkrete të pasqyruara në raport.

Pranimi i fletëve të analizës ose raporteve të provës të lëshuara nga ISHTI, si institucion shtetëror përgjegjës për kontrollin e cilësisë, ose nga laboratorë testues vendas apo të huaj të akredituar, respekton parimin e ekuivalencës dhe shmang kufizimin e pajustificuar të konkurrencës.

Periudha prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh përpara datës së hapjes së ofertave është përcaktuar për të garantuar që rezultatet e analizave të jenë të përditësuara dhe përfaqësuese për produktin që do të furnizohet, pa e detyruar operatorin ekonomik të kryejë një analizë të re posaçërisht për këtë procedurë.

Kur raporti nuk është lëshuar në emër të ofertuesit, dokumentacioni që provon lidhjen e tij me produktin dhe burimin e furnizimit garanton që raporti i paraqitur të mos i përkasë një produkti ose burimi të palidhur me ofertën.

Për këto arsye, kriteri lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe cilësinë e mallit objekt prokurimi, është në përpjesëtim me objektin e Lotit I dhe nuk kufizon në mënyrë të pajustificuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar, nëpërmjet së cilës merr përsipër:

I. Të realizojë furnizimin me karburant nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të Autoritetit Kontraktor.

II. Të prodhojë, personalizojë, aktivizojë dhe dorëzojë kartat elektronike pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

III. Të garantojë furnizimin 24 orë në ditë, gjatë gjithë ditëve të javës, në të paktën 1 (një) stacion të licencuar të shitjes me pakicë të karburanteve brenda qytetit të Shkodrës.

IV. Të realizojë furnizimin vetëm nëpërmjet aparateve matëse/pistoletave publike të stacionit, të kontrolluara dhe të verifikuara metrologjikisht sipas legjislacionit në fuqi.

V. Të mundësojë furnizimin e të gjithë sasisë së karburantit të kontraktuar dhe të administruar nëpërmjet kartave elektronike, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, deri në përfundimin e kontratës.

VI. Të garantojë që sasia e karburantit e ngarkuar në sistem ose në kartat elektronike të mos humbasë, fshihet apo skadojë gjatë zbatimit të kontratës dhe të pakësohet vetëm në përputhje me furnizimet e kryera faktikisht.

VII. Të vërë në dispozicion të Autoritetit Kontraktor një faqe elektronike për menaxhimin e karburantit, të aksesueshme nëpërmjet kredencialeve të sigurta.

VIII. Faqja elektronike duhet të mundësojë të paktën:

- administrimin dhe shpërndarjen e sasive të karburantit;
- rimbushjen, aktivizimin dhe bllokimin e kartave;
- transferimin e sasive ndërmjet kartave;
- përcaktimin dhe ndryshimin e limiteve;
- verifikimin e gjendjes së çdo karte;
- evidentimin e furnizimeve sipas datës, orës, stacionit, targës dhe sasisë;
- gjenerimin dhe eksportimin e raporteve;
- gjurmueshmërinë e veprimeve të kryera në sistem.

IX. Të ofrojë asistencë teknike për kartat dhe faqen elektronike gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

X. Të zëvendësojë pa kosto shtesë kartat e dëmtuara, të humbura ose jofunksionale dhe të transferojë në kartën e re gjendjen e mbetur të karburantit.

Mosparaqitja e deklaratës ose mosmarrja përsipër e të gjitha angazhimeve të mësipërme përbën shkak për skualifikimin e ofertës.

Argumentimi

Kërkesa është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, pika 8, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 561, datë 29.07.2016, “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, e ndryshuar.

Përdorimi i kartave elektronike dhe i faqes së menaxhimit mundëson identifikimin e automjetit, administrimin e sasive, përcaktimin e limiteve dhe gjurmueshmërinë e çdo furnizimi. Furnizimi nëpërmjet pistoletave publike garanton matjen me pajisje të verifikuara metrologjikisht, ndërsa shërbimi 24 orë siguron gatishmërinë e automjeteve për kryerjen e detyrave funksionale.

Kërkesa që sasia e ngarkuar të mos humbasë ose skadojë synon të garantojë furnizimin e plotë të sasisë së kontraktuar deri në përfundimin e kontratës. Kërkesat janë funksionale, nuk lidhen me një markë apo platformë të caktuar dhe mund të përmbushen me çdo zgjidhje teknologjike ekuivalente. Për rrjedhojë, kriteri është i lidhur dhe proporcional me objektin e Lotit I dhe nuk kufizon në mënyrë të pajustificuar konkurrencën.

LOTI II – “Blerje gazoil për kaldaja”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST-së;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4 të DST-së.

Argumentimi

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të neneve 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 26 dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Neni 76 i ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, përcakton kriteret detyruese për skualifikimin e operatorëve ekonomikë.

Në mbështetje të nenit 82 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, së bashku me ofertën, Autoriteti Kontraktor pranon Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të kërkesave të tjera të deklarueshme. Përmbajtja dhe mënyra e përdorimit të këtij formulari përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në zbatim të kësaj dispozite dhe të nenit 26 të VKM-së nr. 285/2021, e ndryshuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9 të DST-së. Dokumentacioni provues paraqitet sipas fazës dhe procedurës së përcaktuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe në DST.

Sipas nenit 83, pika 1, të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në mbështetje të nenit 83, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 162/2020 dhe të nenit 30, pika 1, të VKM-së nr. 285/2021, e ndryshuar, vlera e sigurimit të ofertës përcaktohet në masën 2% të vlerës së përllogaritur të kontratës. Sigurimi i ofertës paraqitet sipas Shtojcës 4 të DST-së dhe duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

Sigurimi i ofertës synon të garantojë seriozitetin dhe qëndrueshmërinë e ofertës gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj, si dhe përmbushjen e detyrimeve të ofertuesit që lidhen me procedurën e prokurimit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të përmbushë kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, sipas përcaktimeve të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Shtojca 9 e DST-së.

Argumentimi

Kërkesa është përcaktuar në mbështetje të neneve 76, 77, pika 2, dhe 82 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatori ekonomik deklaron paraprakisht se nuk ndodhet në kushtet e skualifikimit dhe se përmbush kërkesat e përgjithshme të pranimin dhe të ushtrimit të veprimtarisë profesionale.

Dokumentacioni provues paraqitet nga operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, si dhe në çdo rast kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, sipas legjislacionit të prokurimit publik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Për të provuar kapacitetin ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025.

Vlera e xhiros, në të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të Lotit II, përkatësisht 4 061 478,83 (katër milionë e gjashtëdhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë presje tetëdhjetë e tre) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të kërkuar të xhiros në të paktën një nga tri vitet financiare të përcaktuara.

Argumentimi

Kërkesa është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Kërkesa synon të provojë se operatori ekonomik disponon kapacitetin ekonomik dhe financiar të nevojshëm për realizimin e Lotit II.

Niveli i kërkuar është në përpjesëtim me vlerën dhe natyrën e Lotit II, nuk tejkalon kufijtë e përcaktuar nga legjislacioni dhe nuk krijon pengesa të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Periudha 2023–2025 përfshin tri vitet e fundit financiare të mbyllura përpara zhvillimit të procedurës në vitin 2026. Dokumentacioni paraqitet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar në DST dhe në legjislacionin në fuqi.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë përmbushur detyrimet e maturuara për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025, si dhe këstet e maturuara të vitit 2026, në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe afateve të pagesës të përcaktuara nga secila njësi.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, si dhe në çdo rast kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 76, pika 2, dhe nenit 82 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 26, pikat 2, shkronja “dh”, dhe 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Kërkesa synon të verifikojë përmbushjen e detyrimeve të maturuara për taksat dhe tarifat vendore në të gjitha njësitë ku operatori ekonomik ushtron aktivitet.

Përcaktimi i detyrimeve për vitin 2025 dhe i kësteve të maturuara të vitit 2026 është bërë në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe me afatet e pagesës të përcaktuara nga njësitë përkatëse. Nuk kërkohet shlyerja e detyrimeve që nuk kanë arritur afatin ligjor të pagesës në datën e hapjes së ofertave.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme me objektin e Lotit II, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë të përgjithshme jo më të vogël se 40% e fondit limit të Lotit II, përkatësisht 4 061 478,83 (katër milionë e gjashtëdhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë presje tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Për qëllime të këtij kriteri, konsiderohen furnizime të ngjashme furnizimet me gazoil ose me karburante/lëndë djegëse të lëngshme të ngjashme.

Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore³⁷, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të verifikojë se operatori ekonomik ka përvojën e nevojshme për furnizimin me gazoil ose lëndë djegëse të ngjashme dhe është i aftë të përmbushë detyrimet e Lotit II.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë/autorizim të vlefshëm që lejon tregtimin dhe furnizimin me gazoil ose lëndë djegëse për konsumatorët fundorë.

Për përmbushjen e kriterit pranohet, sipas veprimtarisë që ushtron subjekti:

- a. Licenca me kodin VIII.1.A, lloji “A”, për tregtimin me shumicë të naftës dhe nënprodukteve të saj, e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit; ose
- b. Licenca/autorizimi për tregtimin e lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, i lëshuar nga organi kompetent i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe të nenit 40, pika 5, shkronja “a”, të VKM-së nr. 285/2021, e ndryshuar.

Kriteri mbështetet gjithashtu në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, si dhe në VKM-në nr. 970, datë 02.12.2015, e ndryshuar me VKM-në nr. 344, datë 19.04.2017.

Licenca/autorizimi provon se subjekti që do të realizojë furnizimin ushtron ligjërisht veprimtarinë e tregtimit të gazoilit ose të lëndëve djegëse. Pranimi alternativ i licencës së tregtimit me shumicë ose i licencës për tregtimin të konsumatorët fundorë mundëson pjesëmarrjen e të gjithë subjekteve të autorizuar ligjërisht, sipas formës së aktivitetit që ushtrojnë.

Për këto arsye, kriteri lidhet drejtpërdrejt me objektin e Lotit II, garanton ligjshmërinë e furnizimit dhe nuk kufizon në mënyrë të pajustificuar konkurrencën.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë ose të ketë në dispozicion të paktën 1 (një) mjet autobot/autocisternë, me kapacitet mbajtës jo më të vogël se 2 000 (dy mijë) litra, të përshtatshëm për transportimin dhe shkarkimin e gazoilit në depozitat e kaldajave të Autoritetit Kontraktor.

Mjeti duhet të jetë i pajisur me pompë dhe sistem matës/kontalitär të verifikuar metrologjikisht, për matjen e sasisë së gazoilit të dorëzuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur paraprakisht me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST-së.

Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, si dhe në çdo rast kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë:

- a. lejen e qarkullimit të mjetit;
- b. dokumentin teknik që provon kapacitetin mbajtës të autocisternës;
- c. dokumentin e pronësisë, kontratën e qirasë, marrëveshjen e bashkëpunimit ose dokumentin tjetër juridik që provon disponimin e mjetit;
- ç. certifikatën e kontrollit teknik periodik, të vlefshme;
- d. policën e sigurimit të detyrueshëm, të vlefshme;
- dh. certifikatën e miratimit ADR dhe dokumentacionin teknik të cisternës, kur kërkohen nga legjislacioni për transportin e mallrave të rrezikshme, sipas kategorisë dhe karakteristikave të mjetit;
- e. certifikatën ose dëshminë e vlefshme të verifikimit metrologjik të sistemit matës/kontaltrit, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga një subjekt i autorizuar;
- ë. për drejtuesin e mjetit, lejen e drejtimit të kategorisë përkatëse dhe certifikatën e vlefshme të trajnimit profesional ADR, kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Kur operatori ekonomik mbështetet në kapacitetet e një subjekti tjetër, duhet të plotësohen kërkesat e nenit 84 të ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 90 të VKM-së nr. 285/2021, e ndryshuar, si dhe kërkesat përkatëse të DST-së.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 82 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 26 dhe nenit 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar; ligjit nr. 118/2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”; ligjit nr. 9272, datë 16.09.2004, për aderimin në marrëveshjen ADR; si dhe ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”.

Loti II ka për objekt furnizimin me gazoil të kaldajave, i cili do të transportohet dhe shkarkohet drejtpërdrejt në depozitat e Autoritetit Kontraktor. Disponimi i një mjeti të përshtatshëm është i nevojshëm për të garantuar transportin e sigurt, vazhdimësinë e furnizimit dhe matjen e saktë të sasisë së dorëzuar.

Kapaciteti minimal prej 300 litrash është përcaktuar duke marrë në konsideratë furnizimet periodike dhe kushtet e aksesit në vendndodhjet e kaldajave. Ky kapacitet përbën vetëm prapun minimal; furnizimi mund të realizohet në një ose disa dërgesa, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Pranimi i pronësisë, qirasë, marrëveshjes së bashkëpunimit ose çdo forme tjetër të ligjshme disponimi shmang kufizimin e konkurrencës. Vetëdeklarimi në fazën e ofertimit dhe paraqitja e dokumentacionit provues nga operatori i renditur i pari janë në përputhje me Shtojcën 9 dhe shmangin ngarkimin e panevojshëm të të gjithë ofertuesve me dokumentacion.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), nëpërmjet të cilit të vërtetohet se subjekti që do të realizojë furnizimin ka tregtuar lëndë djegëse në përputhje me standardet dhe legjislacionin shqiptar në fuqi dhe se, sipas evidencave të ISHTI-t, në datën e lëshimit të vërtetimit nuk rezulton të ketë masa administrative përfundimtare në fuqi për shkelje të cilësisë së karburanteve.

Vërtetimi duhet të jetë lëshuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve përpara datës së hapjes së ofertave.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 8, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Kriteri mbështetet gjithashtu në ligjin nr. 8450/1999, i ndryshuar; VKM-në nr. 410/2015, për organizimin dhe funksionimin e ISHTI-t; dhe VKM-në nr. 429/2019, për cilësinë e lëndëve të djegshme të lëngëta për përdorim termik, civil dhe industrial.

Cilësia e gazoit ndikon drejtpërdrejt në funksionimin dhe mirëmbajtjen e kaldajave. Vërtetimi i ISHTI-t mundëson verifikimin e të dhënave zyrtare për subjektin që do të realizojë furnizimin. Kërkesa kufizohet vetëm te masat administrative përfundimtare në fuqi dhe nuk përfshin masa të shfuqizuara, të pezulluara ose ende të papërfunduara.

Afati prej 30 ditësh është përcaktuar që informacioni i administruar nga ISHTI të jetë i përditësuar në datën e zhvillimit të procedurës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analize ose raport prove për gazoilin e ofruar për kaldaja, të lëshuar nga:

a) Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI); ose

b) një laborator testues i akredituar sipas standardit SSH EN ISO/IEC 17025:2017 ose ekuivalent, nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga një organ kombëtar akreditimi i një shteti tjetër, nënshkrues i marrëveshjes EA MLA ose ILAC MRA në fushën e testimit.

Fleta e analizës ose raporti i provës duhet:

- të jetë lëshuar gjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve të fundit përpara datës së hapjes së ofertave;
- të identifikojë produktin e analizuar;
- të përmbajë treguesit dhe rezultatet e analizave të kryera;

- të provojë përputhshmërinë me specifikimet teknike të Lotit II, me kërkesat e VKM-së nr. 429/2019 dhe me standardin SSH EN 590:2025 ose ekuivalent, sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike.
- kur raporti lëshohet nga laborator i akredituar, testet dhe parametrat e pasqyruar në raport duhet të përfshihen në fushën e vlefshme të akreditimit të laboratorit.

Kur raporti nuk është lëshuar në emër të ofertuesit, duhet të paraqitet dokumentacioni që provon lidhjen e ofertuesit me produktin e analizuar dhe burimin përkatës të furnizimit.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 79 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 6, shkronja “c”, dhe nenit 44 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Kriteri mbështetet gjithashtu në ligjin nr. 8450/1999, i ndryshuar; VKM-në nr. 429/2019; specifikimet teknike të Lotit II; standardin SSH EN 590:2025 ose ekuivalent; si dhe standardin SSH EN ISO/IEC 17025:2017 ose ekuivalent.

Fleta e analizës ose raporti i provës i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë se gazoili i ofruar përmbush karakteristikat teknike dhe treguesit e cilësisë të kërkuar për përdorimin në kaldaja. Pranimi i raporteve të lëshuara nga ISHTI ose nga laboratorë testues të akredituar respekton parimin e ekuivalencës dhe shmang kufizimin e pajustificuar të konkurrencës.

Afati prej 12 muajsh siguron që rezultatet e analizës të jenë të përditësuara, pa e detyruar ofertuesin të kryejë një analizë të re posaçërisht për procedurën. Kërkesa për dokumentacionin që lidh raportin me produktin dhe burimin e furnizimit shmang paraqitjen e analizave për produkte të palidhura me ofertën.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar, nëpërmjet së cilës merr përsipër:

- të realizojë, me shpenzimet e veta dhe pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor, transportimin dhe furnizimin me gazoil të kaldajave, nëpërmjet mjetit ose mjeteve autobot/autocisternë të deklaruara dhe të vëna në dispozicion sipas pikës 2.3.3;
- të realizojë furnizimin në institucionet e përcaktuara në Shtojcën “Vendet e furnizimit për kaldajat”, pjesë e DST-së;
- të realizojë çdo furnizim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga marrja e kërkesës së Autoritetit Kontraktor, të dërguar me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike;
- të furnizojë sasinë e përcaktuar në kërkesën e Autoritetit Kontraktor, pa e kushtëzuar furnizimin me një sasi minimale për dërgesë, me kusht që kërkesa të jetë brenda sasisë së përgjithshme të kontraktuar;
- të respektojë gjatë transportimit dhe shkarkimit të gjitha kërkesat teknike, mjedisore dhe të sigurisë të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;
- të përfshijë në çmimin e ofertës të gjitha shpenzimet e transportit, shkarkimit, matjes dhe dorëzimit të gazoilit.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 8, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Loti II ka për objekt furnizimin me gazoil të kaldajave të Autoritetit Kontraktor. Furnizimi do të kryhet sipas nevojave faktike dhe në mënyrë periodike, nëpërmjet shkarkimit të gazoilit në depozitat përkatëse. Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori ekonomik të garantojë transportin dhe furnizimin në kohë, me mjet të përshtatshëm dhe pa kosto shtesë.

Afati prej 24 orësh është përcaktuar për të siguruar vazhdimësinë e funksionimit të kaldajave dhe për të shmangur ndërprerjen e ngrohjes në objektet e administruara nga Autoriteti Kontraktor.

Mosvendosja e një sasive minimale për çdo dërgesë i mundëson Autoritetit Kontraktor të kërkojë furnizim sipas konsumit faktik, kapacitetit të lirë të depozitave dhe nevojave të secilit objekt. Të gjitha sasitë e furnizuara do të jenë brenda sasisë së përgjithshme të kontraktuar.

Furnizimi me gazoil për kaldajat do të kryhet, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, në institucionet e mëposhtme:

Nr.	Institucioni / vendi i furnizimit
1	Shkolla Ismail Qemali
2	Shkolla Xheladin Fishta
3	Shkolla Ali Laçej
4	Shkolla 28 Nëntori
5	Shkolla Jordan Misja
6	Shkolla Oso Kuka
7	Shkolla Shejnaze Juka
8	Shkolla Prenkë Jakova
9	Shkolla 3 Dhjetori
10	Shkolla Pashko Vasa
11	Shkolla Mati Logoreci
12	Shkolla Branko Kadia
13	Shkolla Dëshmorët e Prishtinës

LOTI III – “Blerje benzinë pa plumb për automjete”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST-së;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4 të DST-së.

Argumentimi

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të neneve 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 26 dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Neni 76 i ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, përcakton kriteret detyruese për skualifikimin e operatorëve ekonomikë.

Në mbështetje të nenit 82 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, së bashku me ofertën, Autoriteti Kontraktor pranon Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të kërkesave të tjera të deklarueshme. Përmbajtja dhe mënyra e përdorimit të këtij formulari përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në zbatim të kësaj dispozite dhe të nenit 26 të VKM-së nr. 285/2021, e ndryshuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9 të DST-së. Dokumentacioni provues paraqitet sipas fazës dhe procedurës së përcaktuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe në DST.

Sipas nenit 83, pika 1, të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në mbështetje të nenit 83, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 162/2020 dhe të nenit 30, pika 1, të VKM-së nr. 285/2021, e ndryshuar, vlera e sigurimit të ofertës përcaktohet në masën 2% të vlerës së përllëgoaritur të kontratës. Sigurimi i ofertës paraqitet sipas Shtojcës 4 të DST-së dhe duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

Sigurimi i ofertës synon të garantojë seriozitetin dhe qëndrueshmërinë e ofertës gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj, si dhe përmbushjen e detyrimeve të ofertuesit që lidhen me procedurën e prokurimit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të përmbushë kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, sipas përcaktimeve të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Shtojca 9 e DST-së.

Argumentimi

Kërkesa është përcaktuar në mbështetje të neneve 76, 77, pika 2, dhe 82 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatori ekonomik deklaron paraprakisht se nuk ndodhet në kushtet e skualifikimit dhe se përmbush kërkesat e përgjithshme të pranimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë profesionale.

Dokumentacioni provues paraqitet nga operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, si dhe në çdo rast kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, sipas legjislacionit të prokurimit publik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Për të provuar kapacitetin ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025.

Vlera e xhiros, në të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të Lotit III, përkatësisht 48 934 (dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të kërkuar të xhiros në të paktën një nga tri vitet financiare të përcaktuara.

Argumentimi

Kërkesa është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Kërkesa synon të provojë se operatori ekonomik disponon kapacitetin financiar të nevojshëm për realizimin e Lotit III.

Niveli i kërkuar është në përpjesëtim me vlerën e Lotit III, nuk tejkalon kufijtë e përcaktuar nga legjislacioni dhe nuk krijon pengesa të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Periudha 2023–2025 përfshin tri vitet e fundit financiare të mbyllura përpara zhvillimit të procedurës në vitin 2026. Dokumentacioni paraqitet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar në DST dhe në legjislacionin në fuqi.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë përmbushur detyrimet e maturuara për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025, si dhe këstet e maturuara të vitit 2026, në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe afateve të pagesës të përcaktuara nga secila njësi.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, si dhe në çdo rast kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 76, pika 2, dhe nenit 82 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 26, pikat 2, shkronja “dh”, dhe 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Kërkesa synon të verifikojë përmbushjen e detyrimeve të maturuara për taksat dhe tarifat vendore në të gjitha njësitë ku operatori ekonomik ushtron aktivitet.

Përcaktimi i detyrimeve për vitin 2025 dhe i kësteve të maturuara të vitit 2026 është bërë në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe me afatet e pagesës të përcaktuara nga njësitë përkatëse. Nuk kërkohet shlyerja e detyrimeve që nuk kanë arritur afatin ligjor të pagesës në datën e hapjes së ofertave.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme me objektin e Lotit III, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë të përgjithshme jo më të vogël se 40% e fondit limit të Lotit III, përkatësisht 48 934 (dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Për qëllime të këtij kriteri, konsiderohen furnizime të ngjashme furnizimet me karburante për automjete.

Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore³⁷, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të verifikojë se operatori ekonomik ka përvojën e nevojshme për realizimin e furnizimeve me karburante dhe është i aftë të përmbushë rregullisht detyrimet e Lotit III.

Pranimi i furnizimeve me karburante për automjete, të realizuara nëpërmjet një ose disa kontratave, shmanë kufizimin vetëm të furnizimit identik me benzinë pa plumb. Për këtë arsye, kriteri është proporcional me objektin dhe vlerën e Lotit III dhe nuk kufizon në mënyrë të pajustificuar konkurrencën.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë ose të ketë në dispozicion të paktën 1 (një) stacion të licencuar të shitjes me pakicë të karburanteve për automjete, brenda qytetit të Shkodrës, nëpërmjet të cilit do të realizohet furnizimi me benzinë pa plumb i automjeteve të Autoritetit Kontraktor.

Duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtme:

- a. Licenca/autorizimi i vlefshëm për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjete, i lëshuar nga Bashkia Shkodër;
- b. Leja mjedisore e tipit B, e vlefshme;
- c. Vërtetimin Teknik të vlefshëm për respektimin e normave dhe kushteve teknike të stacionit të tregtimit me pakicë të karburanteve, të lëshuar nga një Organ i Miratuar për Vlerësimin e Konformitetit (OMVK), sipas Urdhrit nr. 315, datë 24.08.2017.
- ç. Certifikata e vlefshme e Mbrojtjes nga Zjarri ose Akti Teknik i vlefshëm, i lëshuar nga shërbimi kompetent i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH);
- d. Dokumenti që provon disponimin e stacionit nga operatori ekonomik.

Disponimi i stacionit mund të provohet me dokument pronësie, ekstrakt të QKB-së, kontratë qiraje, kontratë furnizimi, marrëveshje bashkëpunimi ose dokument tjetër të vlefshëm juridik.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 5, shkronja “a”, të VKM-së nr. 285/2021, e ndryshuar.

Kriteri mbështetet gjithashtu në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, i ndryshuar; VKM-në nr. 970, datë 02.12.2015, e ndryshuar; ligjin nr. 10 448, datë 14.07.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar; ligjin nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, i

ndryshuar; si dhe legjislacionin teknik për kontrollin dhe vlerësimin e konformitetit të stacioneve të karburanteve.

Disponimi i një stacioni brenda qytetit të Shkodrës është i nevojshëm për furnizimin në kohë të automjeteve, shmangien e kilometrave dhe kostove të panevojshme dhe ruajtjen e gatishmërisë së tyre. Dokumentet e kërkuara provojnë ushtrimin e ligjshëm të veprimtarisë dhe përmbushjen e kërkesave teknike, mjedisore dhe të mbrojtjes nga zjarri.

Stacioni nuk kërkohet të jetë në pronësi të ofertuesit. Pranohet çdo formë e ligjshme disponimi që garanton vënien e tij në dispozicion gjatë gjithë kontratës. Për këto arsye, kriteri lidhet me mënyrën e realizimit të Lotit III dhe nuk kufizon në mënyrë të pajustificuar konkurrencën.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), nëpërmjet të cilit të vërtetohet se subjekti që do të realizojë furnizimin ka tregtuar karburante në përputhje me standardet dhe legjislacionin shqiptar në fuqi dhe se, sipas evidencave të ISHTI-t, në datën e lëshimit të vërtetimit nuk rezulton të ketë masa administrative përfundimtare në fuqi për shkelje të cilësisë së karburanteve.

Vërtetimi duhet të jetë lëshuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve përpara datës së hapjes së ofertave.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 8, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Kriteri mbështetet gjithashtu në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, i ndryshuar; VKM-në nr. 147, datë 21.03.2007, e ndryshuar; ligjin nr. 10 433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM-në nr. 410, datë 13.05.2015, për organizimin dhe funksionimin e ISHTI-t; si dhe urdhrin nr. 6, datë 09.01.2015, i ndryshuar.

Cilësia e benzinës pa plumb ndikon drejtpërdrejt në funksionimin, sigurinë dhe mirëmbajtjen e automjeteve. Vërtetimi i ISHTI-t mundëson verifikimin e të dhënave zyrtare për subjektin që do të realizojë furnizimin dhe respektimin prej tij të kërkesave për cilësinë e karburanteve.

Afati prej 30 ditësh garanton që informacioni të jetë i përditësuar në momentin e zhvillimit të procedurës. Për këtë kriter merren në konsideratë vetëm masat administrative përfundimtare në fuqi që lidhen me shkeljen e cilësisë së karburanteve, jo masat e shfuqizuara, të pezulluara ose të papërfunduara.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analize ose raport prove për benzinën pa plumb të ofruar, të lëshuar nga:

a) Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI); ose

b) një laborator testues i akredituar sipas standardit SSH EN ISO/IEC 17025:2017 ose ekuivalent, nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga një organ kombëtar

akreditimi i një shteti tjetër, nënshkruar i marrëveshjes EA MLA ose ILAC MRA në fushën e testimit.

Fleta e analizës ose raporti i provës duhet:

- të jetë lëshuar gjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve të fundit përpara datës së hapjes së ofertave;
- të identifikojë produktin e analizuar;
- të përmbajë treguesit, metodat e provës dhe rezultatet e analizave;
- të provojë përputhshmërinë e benzinës pa plumb me standardin SSH EN 228:2025 ose ekuivalent;
- kur lëshohet nga laborator i akredituar, testet dhe parametrat e paraqitur në raport të përfshihen në fushën e vlefshme të akreditimit.

Kur raporti nuk është lëshuar në emër të ofertuesit, duhet të paraqitet dokumentacioni që provon lidhjen e ofertuesit me produktin e analizuar dhe burimin përkatës të furnizimit.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 79 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 6, shkronja “c”, dhe nenit 44 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Kriteri mbështetet gjithashtu në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, i ndryshuar; VKM-në nr. 147, datë 21.03.2007, e ndryshuar; standardin SSH EN 228:2025 ose ekuivalent; si dhe standardin SSH EN ISO/IEC 17025:2017 ose ekuivalent.

Fleta e analizës ose raporti i provës mundëson verifikimin se benzina pa plumb e ofruar përmbush treguesit e cilësisë dhe kërkesat teknike të standardit përkatës. Cilësia e produktit ndikon drejtpërdrejt në funksionimin, sigurinë dhe mirëmbajtjen e automjeteve të Autoritetit Kontraktor.

Pranimi i raporteve të lëshuara nga ISHTI ose nga laboratorë testues vendas apo të huaj të akredituar respekton parimin e ekuivalencës dhe shmang kufizimin e konkurrencës. Periudha prej 12 muajsh garanton që rezultatet të jenë të përditësuara, pa e detyruar ofertuesin të kryejë një analizë të re posaçërisht për procedurën.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar, nëpërmjet së cilës merr përsipër:

I. Të realizojë furnizimin me benzinë pa plumb nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të Autoritetit Kontraktor.

II. Të prodhojë, personalizojë, aktivizojë dhe dorëzojë kartat elektronike pa kosto shtesë.

III. Të garantojë furnizimin 24 orë në ditë, gjatë gjithë ditëve të javës, në të paktën 1 (një) stacion të licencuar brenda qytetit të Shkodrës.

IV. Të realizojë furnizimin vetëm nëpërmjet aparateve matëse/pistoletave publike të stacionit, të kontrolluara dhe të verifikuara metrologjikisht.

V. Të mundësojë furnizimin e të gjithë sasisë së benzinës pa plumb të kontraktuar dhe të administruar nëpërmjet kartave elektronike, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, deri në përfundimin e kontratës.

VI. Të garantojë që sasia e ngarkuar në sistem ose në kartat elektronike të mos humbasë, fshihet apo skadojë gjatë kontratës dhe të pakësohet vetëm sipas furnizimeve të kryera faktikisht.

VII. Të vërë në dispozicion të Autoritetit Kontraktor një faqe elektronike për menaxhimin e karburantit, të aksesueshme nëpërmjet kredencialeve të sigurta.

VIII. Faqja elektronike duhet të mundësojë të paktën:

- administrimin dhe shpërndarjen e sasive;
- rimbushjen, aktivizimin dhe bllokimin e kartave;
- transferimin e sasive ndërmjet kartave;
- përcaktimin dhe ndryshimin e limiteve;
- verifikimin e gjendjes së çdo karte;
- evidentimin e furnizimeve sipas datës, orës, stacionit, targës dhe sasisë;
- gjenerimin dhe eksportimin e raporteve;
- gjurmueshmërinë e veprimeve të kryera.

IX. Të ofrojë asistencë teknike për kartat dhe faqen elektronike gjatë gjithë periudhës së kontratës.

X. Të zëvendësojë pa kosto shtesë kartat e dëmtuara, të humbura ose jofunksionale dhe të transferojë në kartën e re gjendjen e mbetur.

Mosparaqitja e deklaratës ose mosmarrja përsipër e të gjitha angazhimeve të mësipërme përbën shkak për skualifikimin e ofertës.

Argumentimi

Kërkesa është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, pika 8, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 561, datë 29.07.2016, “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, e ndryshuar.

Kartat elektronike dhe faqja e menaxhimit mundësojnë identifikimin e automjetit, administrimin e sasive, përcaktimin e limiteve dhe gjurmueshmërinë e furnizimeve. Furnizimi nëpërmjet pistoletave publike garanton matjen me pajisje të verifikuara metrologjikisht, ndërsa shërbimi 24 orë siguron gatishmërinë e automjeteve.

Kërkesa që sasia e ngarkuar të mos humbasë ose skadojë synon të garantojë furnizimin e plotë të sasisë së kontraktuar deri në përfundimin e kontratës.

Kërkesat janë funksionale dhe nuk lidhen me një markë apo platformë të caktuar. Për këtë arsye, kriteri është i lidhur dhe proporcional me objektin e Lotit III dhe nuk kufizon në mënyrë të pajustificuar konkurrencën.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në mbështetje të nenit 4, pika 38, shkronja “b”, dhe nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Specifikimet përcaktojnë karakteristikat minimale teknike dhe funksionale që duhet të përmbushin mallrat objekt prokurimi, me qëllim garantimin e cilësisë, sigurisë dhe përshtatshmërisë së tyre për përdorimin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në hartimin e tyre nuk është përdorur asnjë referencë ndaj një marke tregtare, prodhuesi, origjine ose procesi të veçantë që mund të favorizojë ose të përjashtojë operatorë ekonomikë apo produkte të caktuara. Çdo referencë ndaj një standardi teknik shoqërohet me shprehjen “ose ekuivalent”, në përputhje me nenin 36 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar duke mbajtur në konsideratë:

- ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;
- VKM-në nr. 147, datë 21.03.2007, “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”, e ndryshuar;
- VKM-në nr. 429, datë 26.06.2019, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme të lëngëta për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor”;
- VKM-në nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, e ndryshuar;
- standardet shqiptare dhe evropiane në fuqi për cilësinë dhe metodat e provës së produkteve objekt prokurimi.

Standardet teknike të kërkuara për secilin lot janë:

- Loti I – Gazoil për automjete: SSH EN 590:2025, “Lëndë djegëse për automjete – Gazoil (Diezel) – Kërkesat dhe metodat e provës”, ose ekuivalent;
- **Loti II – Gazoil për kaldaja:** kërkesat e VKM-së nr. 429/2019 dhe, për nivelin e cilësisë së produktit të përcaktuar në specifikimet teknike, standardi SSH EN 590:2025 ose ekuivalent;
- Loti III – Benzinë pa plumb për automjete: SSH EN 228:2025, “Lëndë djegëse për automjete – Benzinë automjesh – Kërkesat dhe metodat e provës”, ose ekuivalent.

Për Lotin I, zbatimi i standardit SSH EN 590:2025 ose ekuivalent garanton që gazoili të përmbushë kërkesat teknike dhe metodat e provës për përdorim në automjetet me motor

diesel, duke ndihmuar në funksionimin e rregullt, mbrojtjen e motorëve dhe respektimin e kërkesave për cilësinë e karburantit.

Për Lotin II, kërkesat teknike janë përcaktuar duke marrë në konsideratë përdorimin e gazoilut në sistemet e ngrohjes me kaldaja. Produkti duhet të jetë i pastër, homogjen, pa ujë të lirë, sedimente ose papastërti që mund të cenojnë procesin e djegies dhe funksionimin normal të kaldajave. Referimi të VKM-ja nr. 429/2019 lidhet drejtpërdrejt me përdorimin termik, civil dhe industrial të lëndëve djegëse të lëngëta.

Për Lotin III, standardi SSH EN 228:2025 ose ekuivalent përcakton kërkesat dhe metodat e provës për benzinën pa plumb që tregtohet dhe përdoret në automjetet me motor benzine, duke garantuar cilësinë dhe përshtatshmërinë e produktit.

Kërkesat për cilësinë, transportin, ruajtjen dhe mënyrën e furnizimit janë përcaktuar në funksion të mbrojtjes së automjeteve dhe kaldajave, sigurisë gjatë përdorimit, vazhdimësisë së furnizimit dhe realizimit të rregullt të veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor.

Përputhshmëria e produkteve me specifikimet teknike do të provohet nëpërmjet dokumenteve të cilësisë dhe raporteve të analizës të kërkuara në kriteret e veçanta të kualifikimit. Autoriteti Kontraktor ruan të drejtën që gjatë zbatimit të kontratës të marrë mostra dhe të kërkojë verifikimin e cilësisë së produkteve pranë ISHTI-t, sipas legjislacionit në fuqi.

Përditësimi i referencave nga standardet e shfuqizuara te standardet e vitit 2025 nuk ndryshon sasitë, preventivin ose fondin limit; ai harmonizon dokumentet e procedurës me standardet teknike në fuqi. Për Lotin II, përdorimi i gazoilut me cilësi SSH EN 590:2025 ose ekuivalent realizohet në përputhje me dokumentacionin teknik të kaldajave ekzistuese.